



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.738/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada Glllogjani, Burim Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e Elmi Hajdini votues nga Komuna e Drenasit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.738/2021, i paraqitur nga Elmi Hajdini votues nga Komuna e Drenasit e paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të dt.03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat e kandidatit për Kuvend Komunal, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Drenas Përparim Shala në Vendvotimet 0302E/01R, 0302E/02R, 0302E/03R, 0302E/04R, 0302E/05D.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 03.11.2021, nga Elmi Hajdini votues nga Komuna e Drenasit, me të cilën pretendon se i njëjti në vendvotimet 0302E/01R, 0302E/02R, 0302E/03R, 0302E/04R, 0302E/05D, ka votuar së bashku me familjarët dhe shokët e tij për kandidatin me nr. 5, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ndërsa në këto vendvotime siç pretendon paarshtuesi i apelit votat e tyre nuk janë shënuar për kandidatin në fjalë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se votuesi Elmi Hajdini nga Komuna e Drenasit, ka parashtruar apelin ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet 0302E/01R, 0302E/02R, 0302E/03R, 0302E/04R, 0302E/05D , në Komunën e Drenasit.

Paneli, me rastin e vendosjes së apelit ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga apeli. Pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i apelit se i mungojnë votat e votuesit për kandidatin në fjalë, se në vendvotimin me numër 0302E/01R i njëjti posedon 1 votë, në vv.nr 0302E/02R posedon 2 vota, në vv. nr. 0302E/03R posedon 3 vota , në vv. 0302E/04R posedon 2 vota, në vv 0302E/05D i njëjti posedon 1 votë.

Në fletëvotimet që janë rinumëruar del se kandidati me numër 5 nga subjekti politik PDK, në vendvotimin 0302E/01R ka fituar 1 votë, në vv.nr 0302E/02R ka fituar 2 vota, në vv. nr. 0302E/03R ka fituar 3 vota, 0302E/04R ka fituar 2 vota dhe në vv.nr. 0302E/05D ka 1 votë të gjitha të shënuara në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRK .

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*”, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.738/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.